



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

Akademia e Kosovës për Siguri Publike
Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost / Kosovo Academy for Public Safety

RAPORT VJETOR I PERFORMANCËS

AKSP - 2025

PËRMBAJTJA

I. LISTA E SHKURTESAVE	3
II. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	4
III. HYRJE.....	6
IV. PROGRESI NË ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE TË PLANIT TË PERFORMANCËS	7
V. VLERËSIMI TREGUESVE TË PERFORMANCËS - STATISTIKA.....	17
VI. FINANCAT.....	21
VII. RAPORTI TABELAR I PLANIT TË PËRFORMANCES AKSP 2025.....	22

I. LISTA E SHKURTESAVE

AKSP	Akademia e Kosovës për Siguri Publike
AEPC	Asociacioni i Kolegjeve Policore Evropiane
AKA	Agjencia e Kosovës për Akreditim
AKK	Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
FSP	Fakulteti i Sigurisë Publike
ICITAP	Trajnimi Ndërkombëtar i Hetimeve Kriminale Përkrahja Programore
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
IHZH	Instituti për Hulumtim dhe Zhvillim
ISP	Institucionet e Sigurisë Publike që veprojnë në AKSP
PK	Policia e Kosovës
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
AME	Agjencioni i Menaxhimit Emergjentë
SHKK	Shërbimi Korrektues i Kosovës
SHSK	Shërbimi Sprovues i Kosovës
DK	Dogana e Kosovës
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
Palët e interesit	Institucionet e Sigurisë Publike, duke mos u kufizuar vetëm në: Policia e Kosovës (PK), Dogana e Kosovës (DK), Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK), Shërbimi Sprovues i Kosovës (SHSK), Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) dhe Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME)
Vijues	Personat të cilët vijnë trajnime dhe arsim të lartë në AKSP
IADLES	Asociacionit Ndërkombëtar i Drejtoreve të Standardeve dhe Trajnimit në Zbatimin e Ligjit në SHBA
Partnerët Ndërkombëtar	Partnerët e përhershëm që veprojnë dhe bashkëpunojnë me AKSP-në si ICITAP, OSBE, BE
Bordi i AKSP-së	Organ i cili vepron në kuadër të AKSP-së i cili vendos për standardet minimale profesionale, politikat e trajnimit dhe edukimin e specializuar dhe të avancuar për ASP-të.
Këshilli FSP-së	Organi më i lartë akademik i FSP-së i cili vendos për të gjitha çështjet e rëndësishme në fushën e mësimin, kërkimit dhe hulumtimit shkencor

II. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Akademia e Kosovës për Siguri Publike (tutje AKSP) bazuar në nenin 6 të Rregullore (QRK) Nr. 12/2023 mbi sistemin e menaxhimit të performancës për agjencitë në kuadër të administratës shtetërore ka hartuar Planin Vjetor të Performancës 2025. Brenda afateve ligjore me datë 30.10.2024 zv. Drejtorit të Përgjithshëm të AKSP-së ka përcjell draft dokumentin tek kabineti i MPB-së për fazën e konsultimeve dhe miratimit (konsultim, dialog, akordim dhe miratim të dokumentit Plani Përformancës AKSP 2025). Me datë 30.10.2025 është miratuar Plani Vjetor i Përformancës AKSP për vitin 2025.

AKSP është agjenci ekzekutive në kuadër të MPB-së e cila në bazë të Ligjit Nr. 04/L-053 është përgjegjëse për ofrimin e trajnimeve dhe arsimit të lartë, zbatimin e politikave dhe strategjive të trajnimit dhe të arsimit të lartë, si dhe zhvillimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë publike për të gjitha Institucionet e Sigurisë Publike/ISP por pa u kufizuar vetëm në: Policinë e Kosovës (PK), Shërbimin Korrektues të Kosovës (SHKK), Doganën e Kosovës (DK), Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave (AME), Inspektoratin e Policisë së Kosovës (IPK) dhe Shërbimin Sprovues të Kosovës (SHSK).

AKSP ka hartuar edhe strategjinë e saj zhvillimore institucionale për vitet e ardhshme 2023-2026 ku edhe ka përcaktuar misionin dhe vizionin e saj.

Misioni

Misioni i Akademisë është ofrimi i trajnimeve, arsimimit dhe hulumtim me cilësi të lartë në fushën e sigurisë publike për të ndihmuar në ofrimin e ambientit të sigurtë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Vizioni

Akademia përmes ofrimit të trajnimeve dhe arsimimit me cilësi dhe standarde të ekselencës do të jetë faktor kyç në ngritjen e kapaciteteve të zbatuesve të ligjit konformë ndryshimeve dhe sfidave me të cilat përballen.

Me qëllim të përmbushjes së misionit të saj, AKSP në kuadër të planit vjetor të performancës për vitin 2025 ka paraparë 3 objektiva si vijon:

1. *Ngritja e kapaciteteve/përformancës së zyrtarëve të sigurisë publike përmes trajnimeve*
2. *Konsolidimi i arsimit të lartë në AKSP*
3. *Digjitalizimi dhe automatizimi i proceseve të punës dhe infrastrukturës në AKSP*

Po ashtu objektivat e planit vjetor të performancës 2025 janë inkorporuar edhe në dokumente tjera planifikuese si plani vjetor institucional i punës, etj.

REZULTATET KRYESORE - TË ARRITURAT

Gjatë vitit 2025 AKSP duke ndërmarrë veprime dhe zhvilluar aktivitete për realizimin e objektivave dhe treguesve të performancës ka shënuar rezultate si vijon:

- ❖ Përfundimi i 5 trajnimeve profesionale për ISP-të me 963 kadet / zyrtar të rinj
- ❖ Organizimi i 108 trajnimeve;
- ❖ Trajnimi i gjithsej 2569 zyrtarëve të sigurisë publike;
- ❖ Zhvillimi i 6 trajnimeve të reja nga fusha e sigurisë;
- ❖ Ofrimi i trajnimeve përmes platformave digjitale;
- ❖ AKSP, Anëtare Themeluese e Rrjetit Rajonal të Akademive Policore/Qendrave të Trajnimeve të Evropës Juglindore (RAPATC SEE)
- ❖ Organizimi i 1 tryeze shkencore;
- ❖ Nënshkrimi i 2 marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione vendore dhe ndërkombëtare;
- ❖ Hartimi dhe miratimi i programit studimor bachelor „Siguria Publike”
- ❖ Aplikimi i AKSP-së për Ri-akreditim institucional dhe programor në Agjencinë e Kosovës për Akreditim/ AKA
- ❖ Diplomimi i 40 studentëve – zyrtarëve të sigurisë në FSP/ AKSP
- ❖ Hartimi i 10 akteve normative të brendshme që lidhen me proceset akredituese
- ❖ Rishikimi i standardeve të profesionit për gjashtë (6) agjencionet e sigurisë publike (PK, IPK, DK, SHKK, SHSK, AME)
- ❖ Krijimi i rrjetit dhe bordit Alumni në FSP-AKSP
- ❖ Avancimi i ligjërimit në AKSP përmes metodave dhe pajisjeve të reja teknologjike (SMART BOARD)
- ❖ Zhvillimi i platformës softverike për menaxhimin e trajnimeve dhe proceseve ndërlidhëse me to
- ❖ Krijimi i mekanizmit të Ombuspersonit në FSP
- ❖ Pjesëmarrja e AKSP-së në projekte dhe asociacione vjetore ndërkombëtare
- ❖ Fillimi i projektit për Funkcionalizimin e qytetit simulativ për ushtrime operationale
- ❖ Themelimi i Këshillit të Etikës në AKSP
- ❖ Pranimi i vlerësimit ndërkombëtarë të akreditimit të AKSP-së me „Çmimi i Ekselencës” nga IADLEST – SHBA

SFIDAT DHE NGECJET

Edhe AKSP-ja sikurse institucionet tjera është ballafaquar me sfida të cilat kanë ndikuar në proceset e AKSP-së. Si sfida mund të veqojmë si vijon:

- Mos nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit mes AKSP dhe PK-së lidhur me transferimin e personelit trajnues në AKSP sipas Ligjit të AKSP-së;
- Mos aprovimi i kërkesave shtesë buxhetore në lidhje me implementimin e objektivave dhe projekteve të AKSP-së;
- Çrregullimet e çmimeve të tregut në ofrimin e shërbimeve kryesore.
- Ndalimi – pezullimi i fondit nga SHBA me vendimin e presidentit SHBA-ve në lidhje e implementimin e projektit USFS-SHBA për realizimin e trajnimeve në fushën e emergjencave.

III. HYRJE

Plani i performancës së AKSP-së për vitin 2025 është një dokument i cili është hartuar duke u bazuar në analizimin e gjendjes aktuale dhe proceseve në të cilat ka kaluar institucioni ku si rezultat janë përcaktuar objektivat për avancimin dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të AKSP-së.

Përcaktimi i objektivave në këtë plan është i ndërlidhur edhe me dokumente tjera strategjike si:

- Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitet RKS 2021-2025 (*objektivi 2.3: rendi dhe siguria publike*);
- Plani Strategjik Operacional i MPB-së 2022-2025 (*objektivi 1: Përmirësimi i Sigurisë Publike /MPB- Ngritja e kapaciteteve të sigurisë publike*);
- Standardet vendore dhe ndërkombëtare akredituese (*Agjencisë së Kosovës për Akreditim, Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve dhe standardet IADLEST –SHBA*)

Trajnimi dhe arsimimi i zyrtarëve të sigurisë si faktor kyç në ngritjen e sigurisë publike është sfidë shumë dimensionale. Andaj, përmes zbatimit të planit të performancës kemi arritur t'i avancojmë njohuritë dhe shkathtësitë e duhura për të gjithë pjesëtarët e institucioneve të sigurisë publike duke u bazuar në **praktikat** dhe **standardet** më të mira vendore dhe ndërkombëtare në fushën e trajnimit dhe arsimimit. Përmes këtij raporti pasqyrohet veprimtaria e AKSP-së konformë obligimeve dhe detyrave të saj ligjore.

Të arriturat e periudhës raportuese janë si rezultat i punës së stafit të AKSP-së të cilët kanë dhënë kontributin e tyre qoftë individual apo grupor në kryerjen me përgjegjësi dhe profesionalizëm të plotë të detyrave të punës dhe njëkohësisht duke falënderuar për punën dhe bashkëpunimin e institucioneve të sigurisë publike dhe partnerëve ndërkombëtar të cilët kanë mbështetur AKSP-në në arritjen e sukseseve.

MBLEDHJA E TË DHËNAVE

Monitorimi dhe vlerësimi i realizimit të objektivave dhe efikasitetit të aktiviteteve përkatëse janë paraparë si pjesë integrale e Planit të Performancës AKSP 2025. AKSP bazuar në nenin 8 të Rregullore (QRK) Nr. 12/2023 mbi sistemin e menaxhimit të performancës për agjencitë në kuadër të administratës shtetërore ka hartuar Raportin Vjetor të Performancës 2025. Përveç grumbullimit të dhënave në vazhdimësi përmes raporteve të periudhave të ndryshme kuartale, U.d. Drejtori i Përgjithshëm i AKSP me Vendim nr. 87 datë 06.03.2026 ka themeluar edhe grupin punues ad – hoc me gjithë përfshirje të njësive për grumbullimin e të dhënave me qëllim të hartimit të raportit të performancës institucionale të AKSP-së për vitin 2025. Ky grup punuese ka zhvilluar takime ku edhe janë grumbulluar, shqyrtuar dhe analizuar rezultatet dhe ngeçjet me rastin e implementimit të planit vjetor të performancës institucionale.

IV. PROGRESI NË ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE TË PLANIT TË PERFORMANCËS

Objektivat të cilat i kemi potencuar në përmbledhjen ekzekutive kërkojnë veprime të vazhdueshme gjatë tërë vitit 2025, të cilat janë paraparë në planin e performancës. Me qëllim të përmbushjes së misionit dhe vizionit të saj, AKSP konformë objektivave ka ndërmarrë veprimet si në vijim:

Objektivi 1: Ngritja e kapaciteteve/përformancës së zyrtarëve të sigurisë publike përmes trajnimeve

Nr.	Treguesit dhe aktivitetet	Vlera bazë	Caku	Vlera faktike
1	Numri i trajnimeve profesionale për ISP	5 [2024]	5 (2025)	5 (2025)
2	Numri i zyrtarëve në trajnime profesionale	964 [2024]	1052 (2025)	963 (2025)
3	Numri i zyrtarëve të sigurisë publike të trajnuar	1548 [2024]	2060 (2025)	2569 (2025)
Aktivitetet 1.1. Implementimi i planit vjetor të trajnimeve 1.2. Zhvillimi i trajnimeve të reja në fushën e luftimit të korrupsionit dhe pastrimit të parave 1.3. Krijimi i trajnimeve të reja konformë trendëve të sigurisë publike, nevojave të ISP-ve dhe dokumenteve strategjike 1.4. Realizimi i projektit me USFS-në e SHBA-së për ofrimin e Trajnimeve nga fusha e emergjencave 1.5. Identifikimi dhe Krijimi i standardeve të reja profesionale 1.6. Rishikimi i standardeve të trajnimeve profesionale të ISP-ve				

Aktiviteti: 1.1. Implementimi i planit vjetor të trajnimeve për vitin 2025

Organizimi i trajnimeve profesionale

Gjatë vitit 2025 në AKSP kanë përfunduar **5 trajnime** profesionale për institucionet e sigurisë publike me gjithsej 963 kadetë të diplomuar si vijon:


- ✓ **Policia e Kosovës:** Përfundimi me sukses i pjesës teorike i trajnimit profesional „Zyrtar policor” gjenerata 61 dhe 62 me gjithsej 741 kadetë;
- ✓ **Shërbimi Korrektues i Kosovës:** Përfundimi me sukses i trajnimit profesional „Zyrtar Korrektues” i gjeneratës 45 me gjithsej 114 kadetë.
- ✓ **Dogana e Kosovës:** Përfundimi me sukses i pjesës teorike i trajnimit profesional „Zyrtar doganor” gjenerata 1/2025 dhe 2/2025 me gjithsej 108 kadetë;

Tabela grafike e numrit të trajnimeve profesionale të mbajtura



Agjencionet e sigurisë publike kanë prezantuar kërkesat për ngritjen – rritjen e kapaciteteve të zyrtarëve të sigurisë publike. Bazuar në këto nevoja si dhe kërkesat buxhetore dhe limitet logjistike , AKSP gjatë vitit 2025 ka arritur të diplomoj rreth 963 zyrtar të rinj të sigurisë publike të cilët do të shërbejnë në agjencitë e tyre respektive si (Policia e Kosovës 741 zyrtar të rinj, Shërbimi Korrektues i Kosovës 114 zyrtar të rinj dhe Dogana e Kosovës me 108 zyrtar të rinj)

Tabela grafike: Numri zyrtarëve të sigurisë publike që kanë përfunduar trajnimet profesionale



Organizimi i trajnimeve

Gjatë vitit 2025 AKSP në bashkëpunim me institucionet e sigurisë publike si PK, IPK, DK, SHKK, SHSK, AME, dhe partnerët tanë ndërkombëtar (ICITAP, OSBE dhe Organizata dhe ambasada ndryshme të akredituara në Kosovë) me qëllim të implementimit të planit vjetor të trajnimeve ka organizuar gjithsej **108 trajnime** me gjithsej 2569 zyrtar të sigurisë publike të trajnuar prej tyre sipas gjinisë janë: Meshkuj 2190 ndërsa Femra 379.

Tabela grafike: Numri zyrtarëve të sigurisë publike që janë trajnuar gjatë vitit 2025




Organizimi i trajnimeve ndërkombëtare

Gjatë vitit 2025 AKSP bashku me partnerët ndërkombëtarë ka organizuar trajnime shumë të rëndësishme të cilat kanë kontribuar për ngritjen e kapaciteteve profesionale të zyrtarëve të sigurisë publike si dhe shkëmbimin e përvojave ndërkombëtare.

Gjatë periudhës kohore janë organizuar trajnimet me partnerë ndërkombëtar si vijon:

- Trajnimi për Hetimet e Brendshme për Policinë e Kosovës (OSBE)
- Trajnimi Luftimi i Krimit Mjedisor (OSBE)
- Trajnimi i Trajnerëve mbi De-eskalimin dhe Komunikimin e Ndjeshëm Gjnor (OSBE)
- Trajnimi për Trajnerë Instruktorë të Armëve të Zjarrit (OSBE)
- Kursin e Certifikimit të Programit të Sigurisë së OSBE (Agjencia Suedeze e Kontingjencave Civile/ ASKC)

Tabela grafike: Numri zyrtarëve të sigurisë publike që kanë përfunduar trajnimet profesionale




Tjerë: AKSP, Komuna, ATK, FSK, Gjykata, NJIF, AFK etj.

Aktiviteti 1.2. Zhvillimi i trajnimeve të reja në fushën e luftimit të korrupsionit dhe pastrimit të parave

Me initiative e Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, është inicuar një projekt për trajnimin e zyrtarëve në fushën „Luftimin e Shpëlarjes së Parave (AML)” Ky projekt ka targetuar Njësinë e Inteligjencës Financiare të Kosovës / NJIF-in dhe AKSP-në për qëndrueshmëri të trajnimeve në fushën AML, edhe pse jemi kyçur në fazën e fundit të projektit sipas takimeve me ekspertet e angazhuar nga Ambasada e MB me financimin e tyre kemi zhvilluar një video trajnim **Vetëdijesimi i zyrtarëve për Luftimin e shpëlarjes së parave.**

Gjithashtu me takime dhe komunikim të vazhdueshëm me ekspertet e angazhuar nga AKSP në fushën e trajnimit kemi draftuar **trajnimin e dytë** me titull „**Trajnimi bazik kundër shpëlarjes së parave**” i cili draft është në fazën e zhvillimit të njësave mësimore pasi për qëllimin dhe objektivat dhe përmbajtjen e përgjithshme të pasqyrës së tij kemi akordim formal me ekspertët.

Tabela grafike: Numri trajnime nga fusha luftimit të korrupsionit dhe pastrim parave




Aktiviteti 1.3. Krijimi i trajnimeve të reja konformë trendëve të sigurisë publike, nevojave të ISP-ve dhe dokumenteve strategjike

Gjatë vitit 2025 në AKSP, Departamenti i Trajnimit dhe Përkrahjes Arsimore pas zhvillimit të takimeve me agjencionet e sigurisë publike, për plotësimin e nevojave trajnuese ka identifikuar kërkesat duke prioritetizuar nevojën për zhvillimin e trajnimeve të reja. Identifikimi dhe zhvillimi i trajnimeve të reja është zhvilluar konformë nevojave të ISP-ve dhe dokumenteve strategjike (Kurrikulat e trajnimeve të zhvilluara)

Në bashkëpunim me ekspertet e fushës përkatëse Divizioni për Zhvillimin e Kurikulave ka identifikuar, vlerësuar dhe zhvilluar këto pesë (5) trajnime të reja si vijon:

- ✓ Siguria dinamike
- ✓ Kodi i Ri Doganor
- ✓ Trajnimi - Menagjimi i zemrimit
- ✓ Trajnimi për Zyrtarët e Sigurimit
- ✓ Trajnimi Luftimi i krimit mjedisor

Tabela grafike: Trajnimet e reja të identifikuara dhe zhvilluara



Aktiviteti 1.4 Realizimi i projektit me USFS-në e SHBA-së për ofrimin e Trajnimeve nga fusha e emergjencave

Pavarësisht planifikimit të hollësishëm dhe gatishmërisë operacionale të AKSP-së për zbatimin e projektit të përbashkët me Shërbimin Pyjor të Shteteve të Bashkuara

(USFS), ky aktivitet nuk ka mundur të realizohet gjatë kësaj periudhe raportuese për shkak të faktorëve të jashtëm.

Si pasojë e ndryshimeve në politikat fiskale dhe shkurtimeve të fondeve federale të ndërmarra nga administrata e Presidentit Donald Trump, alokimet e parashikuara për këtë program asistence janë pezulluar. Ky vendim i palës financuese (SHBA) ka prekur drejtpërdrejt mundësinë e mbulimit të kostove operacionale dhe logjistike për ekspertët e USFS-së dhe materialet trajnuese, duke e bërë të pamundur ekzekutimin e projektit sipas marrëveshjes fillestare.

AKSP ka mbajtur komunikim të vazhdueshëm me partnerët, mirëpo kufizimet buxhetore nga pala e SHBA-së kanë qenë përtej kontrollit institucional të Akademisë. AKSP mbetet e përkushtuar që, në momentin e rialokimit të fondeve ose identifikimit të burimeve të tjera alternative, të rifillojë punën për këtë projekt me rëndësi jetike për fushën e emergjencave.

Aktiviteti 1.5 Identifikimi dhe Krijimi i standardeve të reja profesionale

Ne konsultimin të vazhdueshëm me Agjencinë e Forenzikës së Kosovës/AFK-në, menaxhmenti i saj ka shprehur dëshirën e krijimit të Standardit të Profesionit për Zyrtar të Forenzikës, andaj AKSP ka bërë hapa konkretë lidhur me krijimin e këtij standardi me këtë rast ka vendosur edhe si aktivitet në planin e performancës për vitin 2025. Ndryshimet e ndodhura në menaxhmentin e AFK-së ka ndryshuar edhe prioritetet sepse të njëjtit nuk kanë shprehur interesim për vazhdimin e tij andaj ne si AKSP edhe përkundër vullnetit tonë nuk kemi mundur të bëjmë hapa konkretë në këtë drejtim.

Aktiviteti 1.6. Rishikimi i standardeve të trajnimeve profesionale të ISP-ve

Bazuar në vendimin nr. 2/43 të Bordi të AKSP-së, me datë 29.01.2025 u mbajt takimi i parë i grupit punues për rishikimin e standardeve të profesionit dhe krijimin e nëngrupeve profesionale për rishikimin e tyre. Me datë 12.12.2025 pas aprovimit të standardeve profesionale nga Bordi i AKSP të njëjtat me datë 24.12.2025 janë adresuar Standardet e aprovuara nga Bordi i AKSP për miratim në MASHT/KAAPRR.

Objektivi 2: Konsolidimi i arsimit të lartë në AKSP

Nr.	Objektivat, treguesit dhe aktivitetet	Vlera bazë	Caku	Vlera faktike
1.	Treguesi i performancës: Koncepti institucional dhe programor i hartuar	0 (2024)	1 (2025)	1 (2025)
2.	Treguesi i performancës: Arsimi i lartë i konsoliduar për aplikim në AKA	0 (2024)	1 (2025)	1 (2025)
Aktivitetet 2.1. Koncepti i arsimit dhe hulumtimit i hartuar mbi bazën e politikave të harmonizuara; 2.2. Bashkërendimi i politikave rreth arsimit të lartë me akterët relevant (MPB, ISP, AKA, PN); 2.3. Hartimi i planit të përmirësimit duke përfshirë kërkesat akredituese; 2.4. Krijimi i programit studimor i profiluar sipas kërkesave dhe nevojave të sigurisë;				

Aktiviteti 2.1. Koncepti i arsimit dhe hulumtimit i hartuar mbi bazën e politikave të harmonizuara;

Realizimi i këtij aktiviteti është bazuar si rezultat i një analize të thellë të nevojave të institucioneve të sigurisë publike dhe rishikimit të raporteve vlerësuese nga proceset e akreditimit. Është identifikuar nevoja për një kalim nga programi studimor i vjetër me profile të ndara sipas agjencive, drejt një platforme më integruese dhe të standardizuar të edukimit i cili ka rezultuar me hartimin e **Konceptit të ri arsimor**, duke dizajnuar një program unik studimor Bachelor të Sigurisë Publike me fokus të qartë në sigurinë publike. Ky program është produkt i diskutimeve të gjera me akterët kyç të fushës, duke garantuar që kompetencat e fituara të jenë në linjë me realitetin dhe nevojat e fushës së sigurisë. Programi i ri është shqyrtuar dhe miratuar më datë **04.09.2025** nga Këshilli i Fakultetit të Sigurisë Publike.

Po ashtu për të siguruar që arsimi mbështetet në të dhëna dhe kërkim shkencor, është hartuar **Strategjia Hulumtuese FSP-AKSP 2026-2028**. Ky dokument strategjik përcakton prioritetet dhe fushat kryesore hulumtuese për vitet vijuese si dhe harmonizon aktivitetin akademik me nevojat specifike të sigurisë publike.

Aktiviteti 2.2. Bashkërendimi i politikave rreth arsimit të lartë me akterët relevant (MPB, ISP, AKA, PN);

Bashkërendimi i politikave rreth arsimit të lartë është jetik për AKSP dhe FSP duke u bazuar që fushëveprimi i institucionit është ofrimi i arsimit të lartë për hisedarët tanë që janë agjencionet e sigurisë publike.

- ✓ Koordinimi i politikave është realizuar me **MPB** përmes dokumenteve planifikuese të miratuara nga e tyre si objektiv i AKSP-së përmes planeve vjetore dhe planit vjetor të performancës.
- ✓ Po ashtu koordinimi me Institucionet e Sigurisë Publike/**ISP** ka qenë i vazhdueshëm mirëpo ky bashkëpunim konkret është zhvilluar në kuadër të takimeve të Bordit të AKSP-së ku ne takimin e rregullt të Bordit datës 12.12.2025 janë zhvilluar diskutime të shumta në lidhje me implementimin e standardeve akredituese dhe ri konfirmuar përkrahjen e tyre të plotë për proceset e AKSP-së, duke siguruar që programet studimore t'u përgjigjen nevojave operacionale të terrenit.
- ✓ Në të gjitha takimet me partnerin tonë ndërkombëtar **OSBE** janë ofruar bashkëpunime dhe përkrahje për funksionalizimin dhe avancimin e arsimit të lartë

të cilët kanë ofruar mbështetje konkrete për avancimin dhe ofrimin e programit „Master” në fushën e sigurisë publike. OSBE-ja vazhdon të ofrojë përkrahje teknike dhe profesionale për rritjen e standardeve të ligjërimit dhe kërkimit shkencor.

- ✓ Në lidhje me implementimin e standardeve akredituese të caktuara nga AKA, që nga fillimi – aplikimi për akreditimin e programit studimor kemi qenë vazhdimësi duke u koordinuar me Agjencinë e Akreditimit në Kosovë për të siguruar që programet studimore të plotësojnë standardet shtetërore dhe ndërkombëtare të cilësisë. Me datë 31.07.2025 AKSP ka dorëzuar në formatin elektronik dhe fizik dokumentet për aplikimin e ri-akreditimit të programit studimor Bachelor. Ky proces është një hap për të siguruar që institucioni dhe programi të përmbushë standardet e kërkuara për aplikimin. Vizitat vlerësuese dhe procesi akreditues priten në mars 2026

Aktiviteti 2.3 Hartimi i planit të përmirësimit duke përfshirë kërkesat akredituese;

Fakulteti i Sigurisë Publike në bashkëpunim edhe me Divizionin e Sigurimit të Cilësisë me rastin e aplikimit për procesin e akreditimit institucional dhe programor të AKSP-së në Agjencinë e Akreditimit, me datë 20.05.2025 është hartuar plani dinamik i përmirësimit duke përcaktuar afate, persona përgjegjës dhe produktin i cili duhet hartuar sipas standardeve akredituese. Bazuar në këtë plan janë themeluar edhe nëngrupet punuese për hartimin e Raportit Vet vlerësues /RVV hartuar dhe dorëzuar në AKA mbi 134 dokumente.

Pas procesit aplikues dhe dokumenteve të dorëzuara, me datë 02.12.2025 u zhvillua edhe faza e inspektimit në terren nga Ekipi i Eksperteve Vlerësues ndërkombëtar në cilësinë e KSCH-se së AKA. Me datë 27.12.2025 AKSP ka pranuar vlerësimi preliminar shumë pozitiv dhe disa rekomandime nga EE i KSHC së AKA ndërsa tashmë jemi në pritje të vendimit final për akreditim institucional i cili hap rrugë akreditimit programor.

Aktiviteti 2.4. Krijimi i programit studimor i profiluar sipas kërkesave dhe nevojave të sigurisë

Drejtori i Përgjithshëm i AKSP me vendimin nr. 85 datë 19.06.2025, ka themeluar grupi punues për vlerësimin dhe rishikimin e Programit Bachelor në “Siguri Publike” me qëllim të harmonizimit të tij sipas nevojave dhe kërkesave të institucioneve të sigurisë publike.


Vlerësimi, analizimi dhe rishikimi i programit studimor BA në siguri Publike është hartuar nga ana e grupit punues dhe i njëjti është miratuar nga Këshilli i Fakultetit të Sigurisë Publike me datë 04.09.2025 dhe e njëjta është proceduar edhe në Agjencinë e Kosovës për Akreditim me qëllim të nënshtrimit të procesit akreditues..

Objektivi 3: Digjitalizimi dhe automatizimi i proceseve të punës dhe infrastrukturës në AKSP

Nr.	Objektivat, treguesit dhe aktivitetet	Vlera bazë	Caku	Vlera faktike
1.	Treguesi i performancës: Zhvillimi i platformës Softuerike	0 (2024)	1 (2025)	1 (2025)
2.	Treguesi i performancës: Funksionalizimi i qytezës simulative	0 (2024)	1 (2025)	1 (2025)
Aktivitetet 3.1. Zhvillimi i platformës së integruar softuerike për AKSP-së 3.2. Instalimi i pajisjeve të zërimit për nevoja trajnuese, ceremoniale etj 3.3. Avancimi i ligjërimit përmes pajisjeve teknologjike – Smart Board 3.4. Avancimi i shërbimeve të TI përmes rrjetave kompjuterike 3.5. Rritja e sigurisë fizike në hapësirat e AKSP-së përmes digjitalizimit të proceseve / kontrolleve 3.6. Funksionalizimi i qytetit simulativ				

Aktiviteti 3.1. Zhvillimi i platformës së integruar softuerike për AKSP-së

Projekti ka mundësuar digjitalizimin, automatizimin dhe avancimin e shërbimeve administrative dhe trajnuese në AKSP, duke përfshirë menaxhimin e plotë të trajnimeve nga planifikimi, regjistrimi dhe ndjekja e pjesëmarrësve, deri te certifikimi dhe arkivimi i dosjeve të tyre pas përfundimit të trajnimit. Pas inicimit, vlerësimit dhe nënshkrimit të kontratës me datë 14.08.2025 ka përfunduar i njëjti dhe tashmë janë instaluar dhe janë duke e funksionalizuar bazuar edhe në kontratë



Aktiviteti 3.2. Instalimi i pajisjeve të zërimit për nevoja trajnuese, ceremoniale etj

AKSP gjatë vitit 2025 ka paraparë instalimin e pajisjeve të zërimit për nevoja operacionale trajnuese dhe ceremoniale. Ky sistem i zërimit është i nevojshëm për zhvillimin e aktiviteteve, paradave dhe testeve të vrapimit për agjencitë e sigurisë publike, si dhe për avancimin e shërbimeve audio në Qendrën Mësimore Steve Bennet me teknologji moderne për zërim dhe përkthim. Pas inicimit, vlerësimit dhe nënshkrimit të kontratës me datë 14.08.2025 ka përfunduar i njëjti dhe tashmë janë instaluar dhe janë funksionale.

Aktiviteti 3.3. Avancimi i ligjërimit përmes pajisjeve teknologjike – Smart Board

Ky projekt përfaqëson një hap kritik drejt standardizimit të trajnimeve në AKSP me praktikat më të mira ndërkombëtare, duke krijuar një mjedis mësimor modern dhe teknologjikisht të avancuar.

Me realizimin e këtij projekti përmes teknologjisë informative është mundësuar avancimi i shërbimeve të ligjërimit për proceset e trajnimeve në AKSP ku përmes përdorimit të pajisjeve SMARTBOARD lehtësohet dhe avancohet mbajtja e trajnimeve dhe ligjërimeve përmes metodave më interaktive për shkak softuerit të avancuar që ato ofrojnë. Po ashtu edhe shumica e instruktorëve që do ti përdorin pajisjet janë trajnuar për shfrytëzim efikas. Pas inicimit, vlerësimit dhe nënshkrimit të kontratës me datë 14.08.2025 ka përfunduar procesi dhe të njëjtit tashmë janë instaluar dhe janë funksionale. Përmes integritit të teknologjisë informative dhe pajisjeve **SMARTBOARD**, procesi i trajnimit ka kaluar nga metodat konvencionale në ato digjitale dhe interaktive.

Aktiviteti 3.4. Avancimi i shërbimeve të TI përmes rrjetave kompjuterike

AKSP ë kuadër të planit për digjitalizimin dhe rritjen e efikasitetit operacional ka realizuar me sukses projektin për avancimin e infrastrukturës së TI-së. Ky projekt ka përfshirë përditësimin e rrjetave kompjuterike dhe pasurimin harduerik me teknologjinë e fundit.

Realizimi i këtij aktiviteti ka sjellë një transformim rrënjësor në mënyrën se si ofrohen shërbimet:

- Avancimi i rrjetës ka siguruar një lidhje më të shpejtë dhe më të sigurt, duke minimizuar ndërprerjet e shërbimeve online dhe komunikimit të brendshëm.
- Hardueri i ri mundëson zbatimin efikas të platformave të mësimi elektronik (E-learning), duke mbështetur drejtpërdrejt programet arsimore.
- Përmes infrastrukturës së avancuar, është rritur niveli i sigurisë kibernetike dhe mbrojtja e të dhënave sensitive të institucioneve të sigurisë publike.
- Automatizimi i shërbimeve përmes rrjetës së re redukton kohën e procedimit të kërkesave dhe rrit transparencën e punës.

Ky investim nuk është thjesht një përmirësim teknik, por një objektiv strategjik i nevojshëm për të gjitha aktivitetet arsimore dhe trajnuese. Me këtë infrastrukturë, AKSP është tashmë e gatshme t'u përgjigjet kërkesave bashkëkohore të arsimit dhe trajnimit dhe sfidave të sigurisë në epokën digjitale.

Aktiviteti 3.5. Rritja e sigurisë fizike në hapësirat e AKSP-së përmes digjitalizimit të proceseve / kontroleve

AKSP ka ndërmarrë të gjitha veprimet administrative dhe procedurale për realizimin e këtij projekti, duke e konsideruar atë si prioritet për rritjen e standardeve të sigurisë brenda kampusit të tij.

Megjithatë, procesi ka hasur në pengesa financiare si rezultat se aktiviteti është shpallur konformë rregullave të prokurimit publik, i ndarë sipas llojeve përkatëse për të siguruar mbulim specifik të nevojave teknike. Mirëpo pas hapjes së ofertave të pranuar nga operatorët ekonomik, është konstatuar se të gjitha ofertat e vlefshme tejkalonin limitet buxhetore të alokuara për këtë projekt. Kjo rritje e kostove ka ardhur si pasojë e rritjes të çmimeve në tregun e teknologjisë dhe specifikave të larta teknike të kërkuara për sistemet e sigurisë. Duke qenë se AKSP operon brenda kornizave strikte buxhetore, pranimi i ofertave që kalojnë zotimin e mjeteve do të

përbënte shkelje financiare. Për këtë arsye, projekti nuk ka mundur të realizohet në këtë fazë.

Aktiviteti 3.6. Funksionalizimi i qytetit simulativ

Projekti për Rregullimin e qytetit simulativ konsiderohet i një rëndësie të veçantë për ngritjen e kapaciteteve trajnuese operative. Ky ambient specifik, i cili fillimisht është realizuar si donacion nga programi **ICITAP (SHBA)**, kërkon ndërhyrje shtesë infrastrukturore dhe teknike për të siguruar funksionalizimin e tij të plotë sipas standardeve moderne të trajnimit në sigurinë publike.

Projekti është në fazën e ekzekutimit aktiv. Bazuar në planin dinamik dhe kushtet e kontratës, afati i fundit për pranimin teknik dhe përfundimin e plotë të implementimit është muaji qershor i vitit 2026.

Me përfundimin e këtij investimi, qyteti simulativ do të ofrojë:

- ✓ Ambient të plotë dhe të sigurt për skenarë realistikë të trajnimit.
- ✓ Bashkëpunim më të lartë mes agjencive të sigurisë gjatë ushtrimeve simuluese.

V. VLERËSIMI TREGUESVE TË PERFORMANCËS - STATISTIKA

Plani vjetor i performancës së AKSP për vitin 2025 ka paraparë tri (3) objektiva strategjike të cilat përmbajnë 7 tregues të performancës me aktivitete të veprimit për realizimin e planit. E tërë puna dhe përkushtimi i stafit është orientuar drejt realizimit të treguesve të performancës të parapara me plan.

Bazuar në treguesit e performancës të paraparë sipas objektivave mund të konstatojmë si vijon:

Objektivi 1: Ngritja e kapaciteteve / performancës së zyrtarëve të sigurisë publike përmes trajnimeve - Ky objektivi është fokusuar në përmirësimin e aftësive profesionale dhe operacionale të zyrtarëve të sigurisë publike përmes organizimit të trajnimeve të strukturuar dhe të vazhdueshme

- ✓ Numri i trajnimeve të realizuara ka arritur cakun e planifikuar, duke dëshmuar përbushje të plotë të aktiviteteve të planifikuara.
- ✓ Numri i zyrtarëve/kadetëve pjesëmarrës në trajnime është afër caktit 96%, duke reflektuar një nivel shumë të mirë të përfshirjes dhe angazhimit.
- ✓ Numri i përgjithshëm i zyrtarëve të trajnuar ka tejkaluar cakun e paraparë, çka tregon efektivitet të lartë të programeve trajnuese dhe zgjerim të ndikimit të tyre.

Objektivi 2: Konsolidimi i arsimit të lartë - Ky objektivi ka synuar zhvillimin dhe strukturimin e arsimit të lartë brenda institucionit, duke krijuar bazë të qëndrueshme për programe akademike dhe profesionale

- ✓ Hartimi i konceptit institucional dhe programor është përfunduar sipas planifikimit.
- ✓ Konsolidimi i arsimit të lartë për aplikim në AKA është realizuar plotësisht.




Objektivi 3: Digjitalizimi dhe automatizimi i proceseve të punës dhe infrastrukturës në AKSP - Ky objektivi ka pasur për qëllim modernizimin e proceseve përmes teknologjisë dhe rritjen e efikasitetit institucional.

- ✓ Platforma softuerike është zhvilluar dhe funksionalizuar sipas planit.
- ✓ Qyteza simulative është bërë funksionale, duke kontribuar në avancimin e trajnimeve praktike dhe simulimeve.

Vlerësimi i zbatimit të Treguesve të Performancës/TP

Objektivi 1: Ngritja e kapaciteteve / performancës së zyrtarëve të sigurisë publike përmes trajnimeve		Vlera bazë	Caku	Vlera faktike
1	T.P: Numri i trajnimeve profesionale për ISP	5	5	5
2	T.P: Numri i kadetëve - zyrtarëve në trajnime profesionale	964	1052	963
3	T.P: Numri i zyrtarëve të sigurisë publike të trajnuar	1548	2060	2569
Objektivi 2: Konsolidimi i arsimit të lartë		Vlera bazë	Caku	Vlera faktike
1	T.P: Koncepti institucional dhe programor i hartuar	0	1	1
2	T.P: Arsimi i lartë i konsoliduar për aplikim në AKA	0	1	1
Objektivi 3: Digjitalizimi dhe automatizimi i proceseve të punës dhe infrastrukturës në AKSP		Vlera bazë	Caku	Vlera faktike
1	T.P: Zhvillimi i platformës softuerike	0	1	1
2	T.P: Funksionalizimi i qytezës simulative	0	1	1

Paraqitja grafike e vlerësimit të zbatimit të Treguesve të Përformancës sipas objektivave



VI. TË ARRITURAT, SFIDAT DHE HAPAT PËR ADRESIMIN E TYRE

Gjatë vitit 2025 AKSP ka shënuar **rezultate dhe të arritura** duke ndërmarrë veprime dhe zhvilluar aktivitete për realizimin e objektivave të përmbledhura në mënyrë tabelore si vijon:

Fusha trajnimeve
Realizimi i 76 trajnimeve me gjithsej 2039 zyrtar të Institucioneve të Sigurisë Publike
Realizimi me sukses i pjesës teorike në AKSP të trajnimit profesional „Polic i Ri” për gjeneratën 61 dhe 62 të Policisë së Kosovës me gjithsej 741 kadet.
Realizimi me sukses në AKSP i Trajnimit Profesional „Zyrtar Korrektues” gjenerata e 45-të e Shërbimit Korrektues të Kosovës me gjithsej 111 kadetë.
Realizimi me sukses në AKSP i trajnimit profesional „Zyrtar Doganor” gjenerata 01/2025 dhe 02/2025 të Doganave të Kosovës me gjithsej 108 kadetë.
Hartimi dhe miratimi dokumenteve që lidhen me proceset akredituese
Rregullore Nr. 01/2025 për procedurat dhe kriteret e angazhimit të bashkëpunëtorëve të jashtëm në Arsimin e Lartë në AKSP
Rregullore Nr. 02/2025 për organizimin dhe funksionimin e Rrjetit të Alumni të AKSP
Rregullore (AKSP) Nr. 03/2025 për etikë dhe integritet në hulumtimin shkencor,
Rregullore Nr. 04/2025 për masat dhe procedurat disiplinore ndaj personelin Akademik të AKSP
Rregullore Nr.05/2025 për Ombudspersonin e studentëve të Arsimit të Lartë të AKSP-së,
Rregullore Nr.06/2025 për parandalimin dhe mbrojtjen nga ngacmimi dhe ngacmimi Seksual në AKSP
Rregullore Nr.07/2025 për të drejtat e autorit dhe pronësinë intelektuale në AKSP
Rregullore Nr.08/2025 për parandalimin dhe procedurën e kontrollit të plagjiaturës,
Rregullore Nr.09/2025 për veprimtarinë hulumtuese shkencore në AKSP
Rregullore Nr.10/2025 për vlerësimin e performancës së personelit akademik
Nënshkrimi i marrëveshjeve dhe bashkëpunimi
Nënshkrimi i marrëveshjes bashkëpunimit ndërinstitutional mes AKSP dhe Akademisë Policore të Malit të Zi.
Nënshkrimi i marrëveshjes bashkëpunimit ndërinstitutional mes AKSP dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës /KGJK
Pranimi dhe realizimi i vizitave të AKSP-së
Pjesëmarrja në takim me ekspertin e jashtëm monitorues të projektit ‘Home Affairs Program of European Union in Kosovo Project (HAPE)
Pjesëmarrja në takim me përfaqësues ndërmjet AKSP-së, Akademisë së Drejtësisë (AD) dhe Projektit kundër pastrimit të parave (AML) të Ambasadës së Britanisë së Madhe në Kosovë në AD, Prishtinë
Pjesëmarrja në takim me 17-të të Menaxherëve Kombëtarë të LEEd (NLM) të CEPOL në selinë qendrore të CEPOL në Budapest, Hungari
Vizitë në Akademinë e Drejtësisë së Karolinës së Veriut (NCJA) me përfaqësues edhe nga ISP- të (DK, SHSK dhe AME) me përkrahjen e Misionit të OSBE-së në Kosovë
Pjesëmarrja në Asambleenë e Përgjithshme dhe Konferencën Vjetore 2025 të EFSCA-së “EFSCA në zemër të Evropës” (“EFSCA in the Heart of Europe”), Bruksel, Belgjikë
Pjesëmarrja në Konferencën vjetore të IADLEST, Charlotte, Karolina e Veriut, SHBA
Pjesëmarrja në cilësimin e ligjëruesve të 2 zyrtarëve nga AKSP në kuadër të projektit GROWTH të Erasmus+ në Berane, Mali i Zi
Vizitë në Akademinë Policore të Malit të Zi
Pjesëmarrja në Kongresin e 8-të Ndërkombëtar të FRANCPOL, Paris, Francë

Pjesëmarrja e AKSP si anëtare në takimin për themelimin e Asociacionit Rajonal të Akademive Policore/ qendrave të trajnimit të Evropës Juglindore (RAPATC SEE)
Pjesëmarrja në punëtorinë profesionale të organizuar nga Policia Federale Gjermane për modernizimin e trajnimeve në fushën e sigurisë publike në kuadër të projektit evropian "EU-ISF"
SCOPE III – Virtual Classroom" në Qendrën Federale të Trajnimit dhe Arsimit të Policisë në Eschwege, Gjermani
Pjesëmarrja në takimin rajonal Udhëheqësve/Drejtuesve të akademive policore/qendrave të trajnimit dhe përfaqësuesve të policisë kufitare "
Pjesëmarrja në takimin e 14-të të Asociacionit Ndërkombëtar të Akademive Policore (INTERPA) në Nevşehir, Cappadocia, Turqi
Aktivitete dhe ngjarje tjera
Pranimi i vlerësimit ndërkombëtarë të akreditimit të AKSP-së me „ Çmimi i Ekselencës” nga IADLEST – SHBA
Organizimi i tryezës shkencore "Inteligjenca artificiale në sigurinë publike dhe drejtësinë penale: Bashkëveprimi ndërinstitucional për siguri dhe etikë"
Organizimi i Ditës Informuese për Komunitete për 65 të rinj nga AKSP në bashkëpunim me Zyrën për Çështje të Komuniteteve pranë Zyrës së Kryeministrit
Zhvillimi i aktivitetit „ Fuqizimi i rolit të rinisë në paqe dhe siguri” në AKSP
Pjesëmarrja e AKSP-së në panairin e edukimit, Karrierës dhe Punës.
Pranimi i 15 vizitave me 1066 vizitorë/nxënës nga institucione shkollore dhe parashkollore, duke ofruar shërbime informuese gjatë qëndrimit të tyre në AKSP
Pranimi i dhjetëra vizata zyrtare duke përfshirë përfaqësues nga misione diplomatike, organizata ndërkombëtare, si dhe institucione partnere vendore dhe ndërkombëtare
Krijimi i rrjetit dhe bordit Alumni në FSP-AKSP
Krijimi i mekanizmit të Ombuspersonit në FSP
Themelimi i Këshillit të Etikës në AKSP

SFIDAT DHE ADRESIMI I TYRE

Edhe AKSP-ja sikurse institucionet tjera gjatë vitit 2025 është ballafaquar me sfida të cilat kanë ndikuar në mos arritjen a objektivave të parapara si vijon:

Sfidat	Plani për tejkalimin e tyre
1. Mos nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit mes AKSP dhe PK lidhur me transferimin e personelit trajnues nga PK në AKSP për realizimin e mandatit ligjor të AKSP-së në fushën e trajnimeve	- Diskutimi me kabinetin e MPB-së dhe PK-në si agjencion që është i përfshirë në Ligjin e AKSP-së - Nënshkrimi marrëveshjeve për transferimin e përkohshëm të stafit trajnues (instrukturëve) nga PK në AKSP
2. Mos aprovimi i kërkesave shtesë buxhetore	- Analizimi i buxhetit në tërësi në të gjitha kodet ekonomike. - Bartja e mjeteve buxhetore nga një kod në një kod tjetër nëse ka hapësirë. - Aprovimi i buxhetit shtesë me rastin e rishikimit buxhetor dhe përkrahja nga MPB
3. Trajnimet e paplanifikuara dhe mungesa e hapësirave për shkak të organizimit / mbajtjes së trajnimeve profesionale për Institucionet e Sigurisë Publike	- Harmonizimi i kërkesave për trajnime konformë kapaciteteve infrastrukturore dhe buxhetore të AKSP - Ngritja e kapaciteteve trajnuese përmes ofrimit të trajnimeve me sistem elektronik e-learning

	- Koordinimi me ISP për shfrytëzimin e hapësirave të tyre për organizimin e disa trajnimeve të mbikëqyrura nga AKSP (vlerësim, certifikim, monitorim)
4. Ndërlidhja e arsimit të lartë me sistemin e avancimit në agjencione	- Hartimi i politikave plotësuese sipas raporteve të akreditimit me palët e interesit, - Aktivitetet e promovimit të ofertës studimore tek të punësuarit në agjencitë e sigurisë publike; - Ndërlidhja e përfundimit të studimeve në AKSP, me procesin e gradimit / Promovimit në karrierë në agjencitë ligj-zbatuese të diplomuarve.
5. Procedurat tenderuese në prokurimin publik	- Rritja e buxhetit për AKSP sepse çrregullimet e çmimeve të tregut në ofrimin e shërbimeve kryesore po sjellin vonesa për zhvillimin e procedurave tenderuese dhe lidhjen e kontratave - Inicimi me kohë i procedurave
6. Ndërprerja e fondeve nga partnerët ndërkombëtar / Ambasada SHBA-së Kosovë	- Projektet e fituara për zhvillimin e trajnimeve nga fusha e emergjencave të diskutohen edhe me partnerë tjerë

VI. FINANCAT

Të dhënat statistikore janë të marruara nga Raportet e gjeneruara nga SIMFK si dhe Raportet e brendshme financiare për periudhën vjetore 2025.

Tabela e buxhetit, alokimeve si dhe shpenzimeve buxhetore 01.01 – 31.12.2025 (Janar / Dhjetor 2025)								
Kategoritë ekonomike	Buxheti fillestar	Buxheti përfundimtar	Alokuar	Zotimet	Shpenzuara	Mjete të lira	Zotime %	Shpenzim %
Paga & Mëditje	1,269,731.00	1,140,847.00	1,140,847.00	0.00	1,140,847.00	0.00	0.00	100.00
Mallra Shërbime	1,614,221.00	1,569,650.68	1,569,650.68	95,895.15	1,411,567.79	62,187.74	6.11	89.93
Shpen. Komunal	144,030.00	130,701.00	130,701.00	11,842.57	118,857.61	0.82	9.06	90.94
Shpen. Kapitale	817,285.00	817,285.00	817,285.00	285,983.00	531,302.00	0.00	34.99	65.01
Total	3,845,267.00	3,658,483.68	3,658,483.68	393,720.72	3,202,574.40	62,188.56	10.76	87.54

VII. RAPORTI TABELAR I PLANIT TË PËRFORMANCES AKSP 2025

DATA	31.03.2026					
AGJENCIA	AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE-AKSP					
MINISTRIA PËRGJEGJËSE	MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME-MPB					
MISIONI AGJENCISË	Misioni i Akademisë është të ofrojë trajnim, arsimim dhe hulumtim me cilësi të lartë në fushën e sigurisë publike për të ndihmuar në ofrimin e ambientit të sigurtë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.					
OBJEKTIVAT	TREGUESIT	VLERA SYNUAR	VLERA FAKTIKE	REZULTATET (AUTPUTET) E PLANIFIKUARA	REZULTATET E PERFUNDUARA (AUTPUTET) PO/JO	SHENIM SHPJEGUES
1. Ngritja e kapaciteteve/performancës së zyrtarëve të sigurisë publike përmes trajnimeve	Numri i trajnimeve profesionale për ISP	5 [2025]	5 [2025]	Organizimi dhe mbajtja e trajnimeve sipas planifikimit të trajnimeve vjetore ku janë realizuar gjithsej 5 trajnime profesionale për Institucionet e Sigurisë Publike	Po	
	Numri i zyrtarëve në trajnime profesionale	1052 [2025]	960 [2025]	Numri i zyrtarëve në trajnime profesionale ka arritur 960 kadetë të certifikuar prej tyre : ➤ Policia e Kosovës me 2 Trajnime profesional me gjithsej 741 kadetë; ➤ Shërbimi Korrektues i Kosovës me 1 trajnim profesional me gjithsej 111 kadetë dhe ➤ Dogana e Kosovës me 2 trajnime profesionale me gjithsej 108 kadetë.	Po	
	Numri i zyrtarëve të sigurisë publike të trajnuar	2060 [2025]	2569 [2025]	Gjatë vitit 2025 AKSP në bashkëpunim me institucionet e sigurisë publike dhe partnerët tanë ndërkombëtarë (ICITAP dhe OSBE) ka trajnuar gjithsej 2569 zyrtarë	Po	
2.Konsolidimi i arsimit të lartë në AKSP	Koncepti institucional dhe programor i hartuar	0 [2025]	1 [2025]	Koncepti i ri arsimor dhe institucional janë dizajnuar dhe kjo shprehet edhe me rastin e hartimit të programit të studimor me fokus të qartë në sigurinë publike. Ky program është produkt i diskutimeve të gjera me akterët i shqyrtuar dhe miratuar më datë 04.09.2025 nga Këshilli i Fakultetit të Sigurisë Publike	PO	
	Arsimi i lartë i konsoliduar për aplikim në AKA	1 [2025]	1 [2025]	Me datë 31.07.2025 AKSP ka dorëzuar në formatin elektronik dhe fizik dokumentet për aplikimin e ri-akreditimit të programit studimor Bachelor.	PO	

3. Digjitalizimi dhe automatizimi i proceseve të punës dhe infrastrukturës në AKSP	Zhvillimi i platformës Softuerike	1 (2025)	1 [2025]	Digjitalizimi dhe automatizimi i proceseve dhe shërbimeve si dhe integrimi i bazave aktuale të dhënave. Tashmë sipas kontratës deri në afatin 1 vjeçar jemi duke bartur të dhëna dhe shtojmë kërkesa sipas nevojave.	Po	
	Funksionalizimi i qytezës simulative	1 (2025)	1 (2025)	Funksionalizimi i Qytezës simulative për nevojat trajnuese (ushtrimeve operacionale- praktike)	Po	Është duke u implementu kontrata

Datë: 31.03.2026

Shpend Shabani

U.D i Drejtorit të Përgjithshëm të AKSP-së

